



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET

Nr 68 Prot

Datë 04 / 03 / 2020

Lenda : Kërkesë për pajisjen me Aktin e Përputhshmërisë për Dokumentat e Planit të Përgjithshëm Vendor, Bashkia Përmet

Drejtuar: Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit

Bazuar në nenet 9 dhe 23 të Ligjit Nr.107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e Territorit”, kërkojmë pajisjen me Aktin e Përputhshmërisë për Dokumentat e Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Përmet.

Proçesi i hartimit të PPV për Bashkinë Përmet ka filluar me Akt-Marveshjen midis Ministrisë së Zhvillimit Urban (MZHU) dhe Bashkisë Përmet e lidhur më datë 28.08.2017. Më pas, në zbatim të ligjit Nr. 107/2014 “ Për planifikimin dhe zhvillimin e Territorit”, I ndryshuar, Kryetari i Bashkisë si autoriteti përgjegjës për hartimin e dokumentit të plotë të PPV ka marrë vendimin Nr. 75 datë 04.10.2017 për marrjen e Nismës Për hartimin e PPV-së të Bashkisë Përmet si dhe ka ngritur grupin e punës, të cilët janë përgjegjës për hartimin e dokumentit të PPV-së. Gjatë hartimit të PPV janë zhvilluar vizita në terren, katër dëgjesa publike, si dhe takime me Administratorët e Njësive Administrative, Kryepleqtë e fshatrave si dhe persona të tjerë të interesuar për zhvillimin e Bashkisë Përmet. Gjithashtu çdo proçes është konsultuar dhe bashkërenduar me AKPT.

Bashkëlidhur kësaj shkrese është dhe CD me të gjitha dokumentat e Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Përmet.

KRYETARI BASHKISE

Alma HOXHA

Alma Hoxha

